

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës



Vdekshmëria e fëmijëve



Anketa e Treguesve të Shumëfishtë



Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare



Vite para anketës	Shkalla e vdekshmërisë neonatale: SDG 3.2.2	Shkalla e vdekshmërisë post neonatale	Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare: SDG 3.2.1
Kosovë					
0-4	11	4	15	1	16
5-9	10	4	14	1	14
10-14	19	8	27	2	29
Komunitetet Rom, Ashkali and Egjiptian në Kosovë					
0-4	21	5	26	2	27
5-9	12	6	19	3	22
10-14	27	8	34	4	38

Mortaliteti neonatal (NN): probabiliteti i vdekjes brenda muajit të parë të jetës

Mortaliteti Post-neonatal: llogaritet si diferencë në mes të shkallëve të mortalitetit të foshnjave dhe asaj neonatale

Mortaliteti i foshnjeve (1q0): probabiliteti i vdekjes në periudhën nga lindja deri në ditëlindjen e parë


Mortaliteti i fëmijëve (4q1): probabiliteti i vdekjes në periudhën në mes të ditëlindjes së parë dhe të pestë

Mortaliteti i fëmijëve nën 5 vjeç (5q0): probabiliteti i vdekjes në periudhën në mes të lindjes dhe ditëlindjes së pestë


MICS përdor një metodë të drejtpërdrejtë për vlerësimin e mortalitetit të fëmijëve. Kjo përfshin grumbullimin e historive të plota të lindjeve, ku grave të moshës 15-49 vjeç u kërkohet data e lindjes së secilit fëmijë të lindur gjallë, nëse fëmija është ende gjallë dhe, nëse jo, moshë në vdekje.

Dallimet në vdekshmërinë e fëmijëve

Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare sipas karakteristikave socio-ekonomike dhe vendbanimit




Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare sipas faktorëve të rrezikut demografik



Shkallët e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare për periudha 5 vjeçare para anketës, sipas karakteristikave socio-ekonomike, vendbanimit dhe faktorëve të rrezikut demografik

() Shifrat e bazuara në 250-499 raste të papeshuara person-vite të ekspozimit ndaj rrezikut të vdekjes

Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare sipas vendbanimit & gjinisë




Shkallët e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare për periudha 5 vjeçare para anketës, sipas vendbanimit dhe gjinisë

() Shifrat e bazuara në 250-499 raste të papeshuara person-vite të ekspozimit ndaj rrezikut të vdekjes

Mesazhet kryesore

- Shkallët e vdekshmërisë për periudhën pesë-vjeçare para anketës korrespondon afërsisht me periudhën 2014-2020.
- Vlerësohet se 16 fëmijë nën moshën 5 vjeçare vdesin për çdo 1,000 lindje të gjalla. Kjo është pothuajse dy herë më e lartë në mesin e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me 27 fëmijë që vdesin për çdo 1,000 lindje të gjalla.
- Përderisa vlerësohet se 11 fëmijë për çdo 1,000 lindje të gjalla vdesin brenda muajit të parë të jetës në Kosovë, probabiliteti që fëmijët të vdesin midis periudhës së lindjes dhe ditëlindjes së tyre të parë është 15 fëmijë për çdo 1,000 lindje të gjalla.
- Vlerësohet se 21 fëmijë për çdo 1,000 lindje të gjalla nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian vdesin brenda muajit të parë të jetës dhe 26 fëmijë për çdo 1,000 lindje të gjalla vdesin midis periudhës së lindjes dhe ditëlindjes së tyre të parë.
- Shkalla e vdekshmërisë për fëmijët e parë të lindur në Kosovë është 23 fëmijë për çdo 1,000 lindje të gjalla.

Trendet e vdekshmërisë së fëmijëve në moshën 5 vjeçare



Shkalla e vdekshmërisë nën moshën 5 vjeçare për periudhat pesë vjeçare para anketës

Burimi i të dhënave është marrë nga raportet e MICS 2013–2014 dhe 2019–2020 në Kosovë dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali and Egjiptian në Kosovë.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë kryer në 2019–2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA)

dhe UN Women. Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS e Kosovës 2019–2020 dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019–2020 në Kosovë në lidhje me vdekshmërinë e fëmijëve. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat CS.1, CS.2, dhe CS.3 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë). Pasqyrat tjera të shkurtra informative

statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.